



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Vijimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 3/2022 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës (seanca caktuar në orën 11:00).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.**
- 6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data (prezent vetëm në një pjesë të mbledhjes – deri në 13:20).**
- 7. Edmond Hoxha dhe Xhemali Moku (fotograf- deri në një pjesë të mbledhjes prezent), BIRN (në sallë).**
- 8. {...}, inspektor pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (në sallë).**
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

1. Vijimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 3/2022 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës (seanca caktuar në orën 11:00).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme, datë 16.10.2024.

Ju bëj me dije që për arsye objektive Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të jetë prezent në këtë mbledhje. Kështu që në vijim, mbledhja do të drejtohet nga ana ime, Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas rendit të ditës, keni diskutime për rendin e ditës?

Nuk keni diskutime për rendin e ditës.

Atëherë, pika e parë e saj ka të bëjë me vijimin e procedimit disiplinor nr. 3/2022 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, relator është z. Hado.

Ftoj administratën për të njoftuar subjektet për të qenë prezent në këtë seancë dëgjimore.

(Hyn në sallën e mbledhjes Inspektori i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, z. {...}.)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të këtij procedimi disiplinor, nga administrata njoftohem që zoti {...} është njoftuar dhe ka marrë dijeni zoti {...}, i cili është personi i cili në vijueshmëri të këtij procedimi disiplinor ka marrë dijeni për këto procedime disiplinore të zhvilluara nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu në këtë seancë dëgjimore, nëpërmjet autorizimit {...}, datë 15.10.2024 është autorizuar z. {...}, me detyrë inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor nr. 3/2022, në ngarkim të ish-magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, që do të zhvillohet në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Është prezent zoti {...}.

Atëherë në vijim të këtij procedimi, sipas përcaktimeve përkatëse, ju bëj me dije që ditën e sotme janë parashtruar me shkrim pretendimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Meqenëse është prezent në këtë seancë dëgjimore, e ftoj për të dhënë shkurtimisht qëndrimin e tij. Ndërkohë që zoti {...} nuk është prezent në këtë seancë dëgjimore.

Çfarë qëndrimi keni në lidhje me vijueshmërinë.

Ju bëj me dije që zoti {...} ka marrë dijeni nëpërmjet z. {...}.

{...}: Po, faleminderit!

Për sa kohë subjekti i procedimit disiplinor ka marrë dijeni rregullisht për ditën dhe orën e seancës, nuk ka arsye objektive për mosparaqitjen. Kërkoj që të vijojë procesi në mungesë.

Ilir Rusi: Keni diskutime?

Nuk ka diskutime. Atëherë ftoj përfaqësuesin e Inspektorit (ILD) të largohet për të marrë një vendimmarrje Këshilli i Lartë Gjyqësor në lidhje me vijueshmërinë e procedimit disiplinor në mungesë apo jo të tij.

{...}: Për sqarim.

Janë tre procedimet bashkë, apo...?

Ilir Rusi: Janë tre procedime bashkë. Është nr. 3/2022, pastaj është nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023. Por janë në një kohë të ndryshme për t'u zhvilluar për shkak edhe të ardhjes kohore të ndryshme.

Kështu që ju lutem, në momentin që të procedojë Këshilli për vendimmarrje, ju lutem mund të largoheni, për të diskutuar.

{...}: Faleminderit!

Atëherë, paraprakisht...

Ilir Rusi: Ju lutem, mund të largoheni, që të shprehemi në lidhje me vijueshmërinë e procedimit meqenëse zoti {...} nuk është prezent, por nëpërmjet administratës njoftohemi që ka marrë dijeni zoti {...}.

(Largohen nga salla e mbledhjes Inspektori i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, z. {...} si dhe pjesëmarrës të tjerë që ndodhen në sallë, si përfaqësuesit e BIRN dhe znj. Bala (EWMI).)

Ilir Rusi: Atëherë, keni diskutime në lidhje me vijueshmërinë e procedimit disiplinor paçka që zoti {...} nuk është prezent dhe ka marrë dijeni z. {...}, i cili është një lidhje familjare e tij.

Po, zoti Hado!

Ridvan Hado: Si relator i këtyre çështjeve, propozoj që të zhvillojmë seancën dëgjimore në mungesë të subjektit {...}, në të tria rastet, pasi ka marrë dijeni familjari i tij {...}. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime të tjera?

Nuk ka diskutime të tjera.

Hedhim në votim propozimin e z. Hado.

Irena Plaku: Pro, për të tria procedimet.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Edhe Ridvani, dakord për të tria procedimet.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord. Ka marrë dijeni me atë të familjarit, vëllai i tij.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

(Miratohet.)

Ilir Rusi: Ftoj administratën të njoftojë përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të tretët për të qenë prezent në këtë mbledhje plenare.

(Rihyjnë në sallën e mbledhjes Inspektori i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, z. {...} si dhe palë të treta që janë prezent në sallë për të ndjekur seancën.)

Ilir Rusi: Në vijim të këtij procedimi disiplinor, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi që të vazhdojë vijimin e procedimit disiplinor në këtë seancë dëgjimore në mungesë të z. {...}, për shkak se ka marrë dijeni familjari i tij.

Në vijim i japim fjalën përfaqësuesit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i cili në mënyrë shumë sintetike të na prezantojë qëndrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,

5

duke vlerësuar faktin që parashtrimet për këtë procedim disiplinor sapo janë paraqitur me shkrim ditën e sotme.

Gjithashtu bëj me dije që edhe për dy procedimet e tjera disiplinore nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023, do të vijojë shqyrtimi dhe seanca dëgjimore në mungesë të z. {...}.

Tashmë jemi për procedimin disiplinor të vitit 2022, nr. 3.

{...}: Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. {...} prot., datë 27.09.2022 ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për shkelje të rënda profesionale të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 101, pika 1, shkronja “b”, neni 102, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” e ligjit 96/2016 “Për statusin”.

Në përfundim të hetimit disiplinor të kryer, ILD i është drejtuar KLGJ-së me kërkesën për procedimin disiplinor ndaj magjistratit {...}, duke kërkuar caktimin e masës disiplinore “Pezullim nga detyra”.

Ndërkohë, në vijim, në seancën dëgjimore të datës 19.07.2023, të zhvilluar pranë KLGJ-së, pas njohjes me rrethanat faktike lidhur me aktin mjekësor të paraqitur nga vërtetimi i KMACP-së lidhur me subjektin {...}, KLGJ me vendimin nr. 436, 19.07.2023 ka vendosur pezullimin e procedimit disiplinor nr. 3/2022 të filluar ndaj magjistratit {...} për një periudhë kohe prej 1 vit. Ndërsa në vijim KLGJ, me vendimin nr. 523, datë 24.09.2024 vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 436, datë 19.07.2023, të KLGJ-së, për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit {...}; Vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit zoti {...} me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës/Tropojë dhe caktimin e seancës dëgjimore në lidhje më këtë proces.

Nga informacioni i marrë në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, rezulton se ky institucion me vendimin nr. 40/2024, datë 29.07.2024 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {...}, datë 28.07.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit {...}, për të cilin KPK kishte vendosur “shkarkimin nga detyra” të subjektit të rivlerësimit, z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Neni 179, “b”, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. Ndërsa neni 66 i ligjit 84/2016 parashikon se vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit që vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt të menjëhershëm. Ndërsa neni 164 i ligjit 96/2016 parashikon se gjyqtarët e prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit në përputhje me ligjin “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ndërsa neni 139, pika 1, shkronja “c” e ligjit 96/2016, parashikon se Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor nëse ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronja “ç” dhe “d”.

Gjatë ecurisë së procedimit disiplinor ka rezultuar se gjyqtari {...} ka humbur statusin e magjistratit për shkak të aplikimit të masës disiplinore të “shkarkimit nga detyra”, të dhënë me vendimin nr. {...}, datë 28.07.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi nga KPA me vendimin nr. 40/2024, datë 29.07.2024. Ky sanksion i marrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, në kuptim të nenit 179/b, të Kushtetutës, neni 164, pika 1, shkronja “b” të ligjit 96/2016, i ndryshuar, dispozitat kalimtare të tij, passjellë mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit.

Në vijim, referuar nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.

Shqyrtimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...} me detyrë gjyqtar në ish-Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, duhet ndërprerë pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur është bërë i pamundur.

Edhe në lidhje me procedimin nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023, janë të njëjtat rrethana faktike, edhe për këto procedime kërkojmë që të përfundojë procesi pa një vendim përfundimtar, për arsye që parashtrova më sipër.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Keni ndonjë pyetje?

(Nuk ka pyetje.)

Atëherë, meqenëse nuk ka pyetje ia jap fjalën relatorit për vijimin e këtij procedimi disiplinor.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Nuk po ndalem në kronologjinë e çështjes, pasi e tha përfaqësuesi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të gjithë kronologjinë e nisjes së procedimit disiplinor në tre rastet, për magjistratin {...}, pezullimi nga ana jonë dhe heqjen e pezullimit; caktimin e seancës dëgjimore dhe ndërkohë shkarkimin nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe lënien në fuqi të këtij vendimi nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në këto kushte, bazuar në sa më sipër pra, zoti {...} nuk e gëzon më statusin e magjistratit dhe i propozoj mbledhjes plenare mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit {...}, me detyrën gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit pa një vendim përfundimtar.

Kjo kërkesë vlen për të tria rastet siç tha përfaqësuesi i Inspektorit. Megjithatë ne mund ta bëjmë edhe pas çerek ore. Por prapë është kërkesë për të tria rastet. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime të tjera?

Atëherë, ftoj përfaqësuesin dhe pjesëmarrësit e tjerë të largohen, me qëllim që Këshilli të diskutojë për vendimmarrjen përkatëse.

(Largohen nga salla e mbledhjes Inspektori i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, z. {...} si dhe pjesëmarrës të tjerë që ndodhen në sallë, si përfaqësuesit e BIRN dhe znj. Bala (EWMI). Ndërpritet edhe lidhja nëpërmjet platformës me të tretët. Pas marrjes së vendimit, rihyjnë në sallën e mbledhjes Inspektori i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, z. {...} si dhe palë të treta që janë prezent në sallë për të ndjekur seancën. Mundësohet gjithashtu lidhja në platformën online për të tretët.)

Ilir Rusi: Prezent përfaqësuesi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në mungesë subjekti {...}.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

“Për përfundimin e procedimit disiplinor nr. 3/2022 të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedimit disiplinor nr. 3/2022 të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Vijimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 1/2023 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës (seanca caktuar në orën 11:15).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.**
- 6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data (prezent vetëm në një pjesë të mbledhjes – deri në 13:20).**
- 7. Edmond Hoxha dhe Xhemali Moku (fotograf- deri në një pjesë të mbledhjes prezent), BIRN (në sallë).**
- 8. {...}, inspektor pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (në sallë).**
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

2. Vijimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 1/2023 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës (seanca caktuar në orën 11:15).

Ilir Rusi: Në vijim sipas rendit të ditës, vazhdojmë me pikën 2, që ka të bëjë me vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 1/2023 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Sikundër u vendos, jemi në të njëjtat situata ku prezent është përfaqësuesi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë z. {...}, ndërkohë që subjekti z. {...} nuk është prezent

por nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor u vendos vijimi i këtij procedimi në mungesë të tij për shkak se ka marrë njoftim familjari. (*Shih procesverbalin e pikës së parë*).

Në vijim fjalën ia jap z. {...} për të shprehur në mënyrë sintetike argumentet e tij në lidhje me këtë procedim, meqenëse i ka paraqitur edhe parashtrimet me shkrim.

{...}: Po, faleminderit!

Meqë parashtrimet i kam paraqitur me shkrim, jemi në të njëjtën situatë faktike, ku kanë ndryshuar rrethanat për shkak sepse magjistrati ka humbur statusin. Në këto kushte edhe për këtë procedim kërkojmë përfundimin pa një vendim përfundimtar për shkak sepse nuk ekziston objekti dhe qëllimi për të cilin ka filluar.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Ka diskutime?

Nga ana e relatorit çfarë mund të thuhet?

Ridvan Hado: Jam dakord me kërkesën e përfaqësuesit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Nuk po bëj më komente të tjera. Komentet i bëmë në diskutimet i bëmë në procedimin e parë. Jemi në të njëjtat kushte. Magjistrati ka humbur statusin, pra duhet të procedojmë me mbylljen e procedimit pa vendim. Duhet pranuar pra kërkesa e përfaqësuesit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Atëherë, ka diskutime të tjera?

(*Nuk ka diskutime.*)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e propozimit të relatorit z. Hado.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023 të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023 të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Vijimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 2/2023 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës (seanca caktuar në orën 11:30).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.*
- 6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data (prezent vetëm në një pjesë të mbledhjes – deri në 13:20).*
- 7. Edmond Hoxha dhe Xhemali Moku (fotograf- deri në një pjesë të mbledhjes prezent), BIRN (në sallë).*
- 8. {...}, inspektor pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (në sallë).*
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Vijimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 2/2023 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës (seanca caktuar në orën 11:30).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 3 që ka të bëjë me vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 2/2023 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Është e njëjta situatë procedurale ku përfaqësuesi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është prezent, z. {...}, ndërkohë që z. {...} nuk është prezent. Këshilli mori

vendim për vijimin e këtij procedimi disiplinor në mungesë të z. {...}, meqenëse ka marrë njoftim familjari i tij. (*Shih procesverbalin e pikës së parë*).

Për më tej fjalën përfaqësuesit z. {...}.

{...}: Po, faleminderit!

Për sa kohë edhe për procedimin disiplinor nr. 2/2023 i nisur ndaj magjistratit {...} është e njëjta situatë faktike, pasi kanë ndryshuar rrethanat për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit. Në këto kushte edhe për këtë procedim ne kërkojmë përfundimin e procedurës pa një vendim përfundimtar.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Ftoj relatorin.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Edhe unë jam dakord me pranimin e kërkesës së përfaqësuesit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi (të mos bie në përsëritje), magjistrati {...} ka humbur statusin. Pra duhet ta mbyllim procedurën pa një vendim përfundimtar. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime?

(*Nuk ka diskutime.*)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e propozimit të relatorit z. Hado.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023 të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023 të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Vijimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (seanca caktuar në orën 12:00).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.**
- 6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data (prezent vetëm në një pjesë të mbledhjes – deri në 13:20).**
- 7. Edmond Hoxha dhe Xhemali Moku (fotograf- deri në një pjesë të mbledhjes prezent), BIRN (në sallë).**
- 8. {...}, inspektor pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (në sallë).**
- 9. {...}, gjyqtare.**
- 10. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

4. Vijimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj magjstrates *znj. {...}*, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (seanca caktuar në orën 12:00).

(Në sallë ndodhet prezent z. {...}, përfaqësues i ILD.)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të kësaj mbledhjeje do vazhdojmë me pikën 4 që ka të bëjë me vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj magjstrates *znj. {...}*, me funksionin gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Sipas autorizimit përkatës përfaqësuesi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të jetë z. {...}.

Ftoj administratën të njoftojë subjektin magjistraten znj. {...}.

(Hyn në sallën e mbledhjes znj. {...}.)

Ilir Rusi: Atëherë, kolegë, në vijim të kësaj mbledhjeje doja të bëja me dije situatën time gripale, dhe për këtë arsye edhe pjesa e zërit është në këtë lloj formati. Por besoj do të jem i kuptueshëm me ju përgjatë kësaj mbledhjeje dhe për të tretët të cilët janë duke dëgjuar.

Ne në raport me atë çfarë kemi përcaktuar dhe kemi publikuar për këtë rend dite, kishim përcaktuar intervale kohore të ndryshme për këto procedime disiplinore, për shkak sepse kishim vijimin e katër procedimeve disiplinore të zhvilluara në këtë ditë.

Përfunduar me tre procedime disiplinore, me z. {...}. Tashmë ora është 12:00 dhe po vazhdojmë me vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj magjistrates {...} me funksionin gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Seancë e caktuar në orën 12:00. Sipas orarit dhe për shkak edhe të prezencës së subjekteve, përfaqësuesit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. {...} dhe subjektit magjistrates, ish-magjistrates znj. {...}, janë prezent.

Në vijim, fjalën edhe sipas përcaktimeve ligjore, fjalën ia jap z. {...}, meqenëse edhe i ka paraqitur parashtrimet e veta me shkrim, në mënyrë sintetike të na paraqesë qëndrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me vijimin e këtij procedimi disiplinor.

{...}: Po, faleminderit!

Atëherë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 2292, datë 14.07.2023 ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkelje të rënda profesionale të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, e ligjit 96/2016.

Në përfundim të hetimit disiplinor, ILD i është drejtuar KLGJ-së me kërkesën për

procedimin disiplinor ndaj magistrates {...}, duke kërkuar si masë disiplinore “Shkarkimin nga detyra”.

Ndërkohë, në seancën dëgjimore të datës 29.02.2024, të zhvilluar pranë KLGJ-së, KLGJ pas njohjes me rrethanat faktike, si Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. {...}, datë 10.09.2021 ka vendosur “shkarkimin nga detyra” të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 97, datë 29.02.2024 ka vendosur pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj {...}, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. {...}, datë 10.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ndërkohë, me marrjen e vendimit nga KPA-ja, KLGJ me vendimin nr. {...}, datë 11.07.2024 vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 97, datë 29.02.2024 për pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024 dhe vijimin e tij.

Nga informacioni i marrë në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelit rezulton se ky institucion me vendimin nr. 32/2024, datë 03.07.2024 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {...}, datë 10.07.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit {...}.

Neni 179, “b”, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. Ndërsa neni 66 i ligjit 84/2016 parashikon se vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit që vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt të menjëhershëm. Neni 164 i ligjit 96/2016 parashikon se gjyqtarët e prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit në përputhje me ligjin “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë ecurisë së procedimit disiplinor sa më sipër ka rezultuar se gjyqtare {...} ka humbur statusin e magistratit për shkak të aplikimit të masës disiplinore të “shkarkimit nga detyra”, dhënë me vendimin nr. {...}, datë 10.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi nga KPA me vendimin nr. 32/2024, datë 03.07.2024. Ky sanksion i marrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, në kuptim të nenit 179/b, të

Kushtetutës, neni 164, pika 1, shkronja “b” e ligjit 96/2016, i ndryshuar, passjellë mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit.

Në vijim, referuar nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.

Shqyrtimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistrates znj. {...} me detyrë gjyqtare në ish-Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duhet ndërprerë pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur është bërë i pamundur.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Ftoj ish-magjistraten znj. {...} për të shprehur opinionet e veta.

{...}: Përderisa me vendimin e Komisionit të Pavarur të Apelit kam humbur statusin e gjyqtarit, magjistratit, shumë e shpjegoi edhe përfaqësuesi i ILD-së... Kaq. Kam ardhur këtu në respektin tuaj, meqenëse dje u lajmërova nga sekretaria që duhet të isha prezent edhe erdha për respektin tuaj.

Ju uroj punë të mbarë dhe shëndet mbi të gjitha. Kaq.

Ilir Rusi: Faleminderit znj. {...}.

Atëherë, ftoj relatoren për të shprehur opinionet dhe qëndrimet e veta.

Gentiana Muçaj: Atëherë, për të mos rënë në përsëritje, se u relatua nga përfaqësuesi i ILD-së, u pranua edhe nga subjekti ish magjistratja {...}, atëherë unë propozoj mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistrates {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit pa një vendim përfundimtar.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçaj!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Nuk ka diskutime.

Atëherë, ftoj përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe znj. {...} të largohen me qëllim që të procedojë Këshilli me vendimmarrjen përkatëse.

Mund të prisni se do t'ju komunikohet vendimi.

(Largohen nga salla e mbledhjes Inspektori i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, z. {...}, ish-gjyqtarja znj. {...}, si dhe pjesëmarrës të tjerë që ndodhen në sallë, si përfaqësuesit e BIRN dhe znj. Bala (EWMI). Ndërpritet edhe lidhja nëpërmjet platformës me të tretët. Pas marrjes së vendimit, hyjnë në sallën e mbledhjes Inspektori i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, z. {...}, ish-gjyqtarja {...}, si dhe palë të treta që janë prezent në sallë për të ndjekur seancën. Mundësohet gjithashtu lidhja në platformën online për të tretët.)

Ilir Rusi: Atëherë vendim “Për përfundimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj ish-magjistrates {...}, pa një vendim përfundimtar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj ish-magjistrates znj. {...}, pa një vendim përfundimtar.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet znj. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ilir Rusi: Në vijim, edhe me kërkesë të anëtarëve, 5 minuta pushim.

Ftoj subjektet të largohen.

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} si dhe ish-magjistratja zonja {...}.)

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

25

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 16.10.2024 (Pika 5)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
2. **Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.**
3. **Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
5. **Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.**
6. **Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data (prezent vetëm në një pjesë të mbledhjes – deri në 13:20).**
7. **Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).**
8. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Atëherë, të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas këtij rendi dite do vazhdojmë me pikën 5 që ka të bëjë me shqyrtimin e këtij projektvendimi, “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit për 1 (një) vit”, për të cilin është përgatitur relacioni i Komisionit të Zhvillimit Karrierës. Për më tej fjala relatorit zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Të nderuar kolegë!

Paraqes relacionin që i bashkëlidhet projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit”.

Në Këshillin e Lartë Gjyqësor me shkresën nr. {...} prot., datë 09.07.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 11.07.2024, Gjykata e Lartë ka kërkuar konfirmimin për një periudhë njëvjeçare të ndihmësmagjistrates znj. {...}, si e komanduar në Gjykatën e Lartë.

Në këtë shkresë, theksohet se në kushtet që aktualisht rezulton që Gjykata e Lartë ka vetëm 10 ndihmësmagjistratë të komanduar, ndërkohë që në referim të nenit 34, pika 4 të ligjit nr. 96/2016, më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë të njësisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë duhet të përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kryetari i Gjykatës së Lartë vlerëson të nevojshme që Këshilli i Lartë Gjyqësor të vendosë konfirmimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, duke përsëritur komandimin e saj edhe për një periudhë 1 (një) vjeçare.

Në analizë të kërkesës nga Gjykata e Lartë, relatori u mbështet në kushtet dhe kriteret për pozicionin që kërkon komandimi në Gjykatën e Lartë parashikuar në nenin 56 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar kushtet dhe kriteret parashikohen në këtë dispozitë.

“1- Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme me mandat pesëvjeçar, me të drejtë ripërsëritje, me kërkesë të institucionit ku komandohet magjistrati.

2- Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ose i Gjykatës së Lartë, tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit të një ndihmësmagjistrati, mund t’i paraqesë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmësmagjistratit si i komanduar në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën Kushtetuese. Këshilli konfirmon ndihmësmagjistratin nëse është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin etik dhe profesional, si dhe nëse ndihmësmagjistrati ka dhënë pëlqimin për konfirmim.”

Nga aktet e administruara në dosjen personale të gjyqtares përcjellë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, rezulton se znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 20.07.2012; ka

përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në “E drejtë civile” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendimin nr. 8, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare. Me vendimin nr. 48, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendimin nr. 434, datë 14.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, komandohet në pozicionin ndihmësmagjistrate në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, për një periudhë 3 (tre) vjeçare. Me vendimin nr. 477, datë 13.09.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konfirmohet si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë dhe i zgjatet afati i komandimit për një periudhë 1 (një) vjeçare, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 vite. Znj. {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin e datës 14.10.2020, vendosi komandimin e gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, znj.{...}, si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë për periudhën 3-vjeçare. Në mbështetje të dispozitës pra të nenit 56 vijues të ligjit për statusin, relatori kërkoi dhe analizoi, administroi të gjitha aktet që përbëjnë kusht dhe janë të nevojshëm për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës së saj. Pikërisht administruam:

1. Kërkesën e Gjykatës së Lartë ku pasqyrohet kërkimi për ripërtëritjen e komandimit të ndihmësmagjistrates;
2. Pëlqimin e magjistrates;
3. Të ketë një interes publik për konfirmimin si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë
4. Vlerësimin etik dhe profesional. (janë kushtet e kërkuara nga neni 56 i Ligjit për statusin).

Në referim të nenit 56, pika 2, Kryetari i Gjykatës së Lartë, tre (3) muaj para mbarimit të mandatit paraqiti kërkesën, pranë Këshillit, me shkrim, për konfirmimin e ndihmësmagjistrates. Pra plotëson kushtin e parë.

Kushti i dytë – rezulton se znj. {...}, më datë 01.07.2024, ka dhënë pëlqimin për t’u konfirmuar si ndihmësmagjistrate, duke kërkuar përsëritjen e komandimit edhe për një vit. Sipas vlerësimit të gjyqtarës, eksperiencia e deritanishme pranë Gjykatës së Lartë, ka

qenë e tillë që ka lejuar të kontribuojë në mbarëvajtjen e punës së autoritetit më të lartë gjyqësor dhe njëkohësisht e ka zhvilluar karrierën e saj profesionale.

Në kuadër të trajtimit të kërkesës së paraqitur për konfirmimin e komandimit të znj. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës me shkresën e datës 01.10.2024 i kërkoi një informacion Gjykatës së Lartë lidhur me numrin e përgjithshëm të praktikave gjyqësore ngarkuar magjstrates gjatë periudhës së komandimit në kuadër të ofrimit të shërbimit të këshilltarit ligjor. Në përgjigjen e ardhur nga Gjykata e Lartë, me shkresën e datës 07.10.2024, rezultoi se: “Znj. {...} ka trajtuar një numër prej njëmijë e pesëqind praktikash në total si dhe ka përgatitur relacione të ngarkuara magjstrates gjatë periudhës së komandimit 2020-2023 në kuadër të ofrimit të shërbimit të si këshilltare ligjore. Në përgjigje të Gjykatës së Lartë është referua se znj. {...} ka ushtruar funksionin e ndihmësmagjistratit duke përgatitur relacione pranë Këshillit Administrativ për periudhën 2020-2023 si dhe pranë Këshillit Civil për periudhën 2020-2021. Për sa i përket periudhës 24.07.2024- 01.10.2024 është përcjellë informacioni i gjeneruar nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, nga ku rezulton që ndihmësmagjistratja znj. {...} ka përpunuar, domethënë ka përgatitur materiale gjithsej 475 relacione. Bashkëlidhur këtij relacioni janë dhe aktet që ne i kemi dërguar në Këshill”.

Për të vijuar më tej, siç thamë, një nga kriteret e parashikuara nga neni 56 i ligjit “Për statusin” është edhe “Magjistrati duhet të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin etik dhe profesional. Në lidhje me këtë kriter ne jemi drejtuar si komision, jemi drejtuar Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshillin e Lartë Gjyqësor me shkresën e datës 1.10.2024 për Vlerësimin të Etik dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshillin e Lartë Gjyqësor për vlerësimin etik dhe profesional të znj. {...}, pasi kriteri ligjor për pranueshmërinë e kërkesës përcakton minimumin e vlerësimit në nivelin “shumë mirë” të saj.

Në përgjigje të kërkesës së relatorit lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të znj. {...} nga ana e Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale është parashtruar ndër të tjera... . Parashtrësja është e gjatë. Mund ta përmbledh në mënyrë të shkurtuar në këtë parashtrësë që për t’u bërë vlerësimi i znj. {...}, ajo është përfshirë në periudhën e vlerësimit, në programin e periudhës së vlerësimit, por për të bërë vlerësimin e saj sipas nenit 56 të ligjit “Për statusin” do të duhet që ajo të konsumonte tërësisht

mandatin prej pesë (5) vjetësh. Meqenëse nuk e ka konsumuar mandatin prej pesë vjetësh asaj nuk mund t'i bëhet vlerësimi referuar nenit 56 të ligjit "Për statusin". Është një praktikë që është e konfirmuar edhe vitin e kaluar pasi znj. {...} ka përsëritur dhe vitin e kaluar kërkesën e saj për të zgjatur afatin e komandimit dhe është i njëjti qëndrim që është mbajtur si vitin e kaluar edhe këtë vit. Pra vlerësimi i saj do të bëhet pasi të përfundojë mandatin prej 5 vjetësh si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

Vlerësimi Etik dhe profesional përben një nga kushtet e vlerësuara nga Këshilli në procesin e vendimmarrjes në lidhje me pranimin e kërkesës. E perifrazova, thashë, në mënyrë të shkurtuar këtë pjesën. Këto ishin pak a shumë ato konstatimet e sjella nga shkresa prej Komisionit të Veprimit Etik.

Duke marrë në konsideratë faktin që Institucioni Komandimit të gjyqtarëve pranë njësisë ligjore të Gjykatës së Lartë është për t'u vlerësuar sepse lejon gjyqtarëve magjistratë jo vetëm të zgjerojnë spektrin e tyre të nevojës, por mundëson autoritetin më të lartë gjyqësor për të përfituar nga përvoja e tyre si gjyqtar, relatori është drejtuar dhe Gjykatës së Lartë për të administruar një vlerësim për kontributin e saj në këtë institucion. Në këto kushte kur kjo magjistrate është rekrutuar në strukturën juridike profesionale më të rëndësishme të Gjykatës së Lartë, vlerësimi i saj në përputhje me skemat e vlerësimit të këtij institucioni do të mund të zëvendësonte vlerësimin etik dhe profesional të Këshillit, i cili për shkaqe objektive, ka rezultuar se nuk mund të kryhej duke vepruar në këtë mënyrë në përputhje me qëllimin e ligjit në përcaktimin e plotësimit të këtij kushti, parashikuar nga neni 56.

Në shkresë janë dhënë të gjitha dosjet që ajo ka marrë përsipër, relacionet që ka bërë përsipër, kryesisht relacionet ka përfunduar për çështjet që lidhen me fushën e të drejtës administrative. Në një vit thashë ajo ka bërë edhe çështje të të drejtës administrative në Gjykatën e Lartë si ndihmësmagjistrate, por dhe çështje që mbulojnë fushën e së drejtës civile, ishte viti 2020-2021. Prej kësaj kohe e në vijim, ka vijuar më tej me relacione që i ka përgatitur në fushën e të drejtës administrative. Ngarkesa e punës së ndihmësmagjistratëve në Gjykatën e Lartë është përfshirë në shkresën e drejtuar nga kryetari. Shkresën ju e keni në materialet që ne kemi dërguar të kryetarit të Gjykatës së Lartë. Kështu që nuk po e lexoj të gjithën. Mendoj se është e njohur.

Më tej, në kuadër edhe të analizës së moscenimit të interesit publik të cilin Këshilli i Lartë Gjyqësor si institucion i pavarur në kuptim të nenit 147/a të Kushtetutës është i detyruar të mbrojë, relatori përveç Vlerësimit të Kontributit të magistrates pranë Gjykatës së Lartë, me anë të vendimmarrjeve të saj, ka administruar edhe ngarkesën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, ngarkesë e së cilës deri në qershor të vitit 2024 paraqitet si vijon, është ngarkesa e të gjithë gjyqtarëve. Nuk po i përmend por gjyqtarët kanë çështje nga 325 çështje në shqyrtim deri në 82 çështje në shqyrtim. Janë të gjitha të pasqyruara dhe të integruara në relacioni tonë. Nuk po i përmend një nga një emrat e gjyqtarëve por janë të pasqyruara dhe ngarkesa e tyre përkatëse.

Nga ky vlerësim i ekuilibruar i komisionit, të drejtë të interesave, rezulton se vijimi i komandimit pranë Gjykatës së Lartë sjell, mendojmë neve si komision, më tepër dobishmëri dhe efektshmëri shërbimi magistrates pranë kësaj të fundit sesa nëse ajo do të shkonte në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Kjo jo vetëm për faktin e rëndësisë së jashtëzakonshme të njësisë së shërbimit ligjor të Gjykatës së Lartë, të cilën ligji e konsideron si një figurë “quasi” gjyqësore, pamundësinë e sistemit për ta plotësuar dhe më shumë me gjyqtarë këtë komponent të Gjykatës së Lartë siç kërkohet nga ligji, numri i madh i jashtëzakonshëm i çështjeve të mbartura vit pas viti për zvogëlimin e të cilave kërkohet patjetër, detyrimisht edhe shërbimi i ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, vlerësimi i objektivit i dobishmërisë dhe efektshmërisë si dhe shmangja e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre, na lejon të konkludojmë se përmbushen të gjitha kriteret ligjore që të mundësohet edhe një herë përsëritja e komandimit.

Ndodhur në këto kushte, ne i propozojmë Këshillit, që plotësohen të gjitha kriteret e parashikuara nga neni 56 dhe në vijim, i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndodhur në këto kushte ne i propozojmë Këshillit që të konfirmohet si ndimësmagjistrate në Gjykatën e Lartë gjyqtarja znj. {...} duke vendosur zgjatjen e mandatit të komandimit edhe për një vit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi,

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Po.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord,

Bledar Bajri: Dakord me konfirmimin.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Konfirmimin si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...}, duke vendosur zgjatjen e mandatit të komandimit me një vit.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 20.10.2024.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Lartë si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

33

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 16.10.2024 (Pika 6)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Pritfi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.*
- 6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data (prezent vetëm në një pjesë të mbledhjes – deri në 13:20).*
- 7. Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239 datë 02.05.2024, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, për

kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Gjithashtu për shkak të akustikës të kësaj salle, do doja që diksioni të ishte në një mënyrë të tillë për t’u reflektuar tek të tretët.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Relacioni rradhës i referohet projektvendimit për tërheqjen e z. {...} nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin 239, datë 02.05.2024 të Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Me vendimin nr.233 - nr.243, datë 02.05.2024 si dhe vendimi nr.260, datë 16.05.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushat e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit ishte data 16.05.2024 dhe data 30.05.2024, (i referohem datës 30.05.2024 për pozicionin e shpallur në vendim nr.260, datë 16.05.2024).

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr. 239, datë 02.05.2024 kandidoi edhe z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 239/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 277/2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose që mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë ishte përfshirë dhe z. {...}, pra ishte pulli ose pozicioni ku ishin kandidatë vetëm gjyqtarë që kishin ose mund t’u bëhej një vlerësim, ku ishte përfshirë edhe z. {...}.

Me vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë/ dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 233 - 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260”, Këshilli vendosi:

Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore për kandidatët në pozicionet e përmendura më lart, si dhe caktimin e relatorit për secilin kandidat si më poshtë: Për kandidatin z. {...} relator jam caktuar unë, relator për verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit.

Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin z. {...}, në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore” si dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli, me vendimin nr. 415, datë 30.07.2024, vendosi:

Kualifikimin e z. {...} si dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239.

Në vijim të procedura, më datë 20.09.2024 kandidati z. {...}, paraqiti kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 239.

Në rrethanat e mësipërme ... pra kjo kërkesë është protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 20.09.2024.

Në rrethanat e mësipërme përgatitet edhe relacioni përkatës referuar vendimit të Këshillit nr.320, datë 17.09.2020 sipas të cilit, në rrethanat tona, është përcaktuar se: “Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi në çdo kohë, derisa nuk ka përfunduar procedura e lëvizjes paralele, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim”, si dhe në pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele.

Ndodhur në këto kushte, ne si Komision vlerësojmë se ndodhemi përpara situatës së përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë, të shpallur, në fushën e të

drejtës civile, me vendimin e Këshillit nr. 239 datë 02.05.2024, për shkak se kandidati z. {...} në këtë rast është tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion.

Kështu që procedura e mëtejshme e verifikimit për këtë kandidat duhet të përfundojë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si

37

dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, për kandidatin znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

39

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 16.10.2024 (Pika 7)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.*
- 6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data (prezent vetëm në një pjesë të mbledhjes – deri në 13:20).*
- 7. Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, për kandidatin znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, për

kandidatin znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Projektvendimi i radhës, kemi përgatitur relacionin për projektvendimin e radhës që bën fjalë “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, për kandidaten znj. {...}”.

Ndodhemi në të njëjtën situatë, në të njëjtën situatë me atë çfarë unë referova për zotin {...}. Në këtë rast pozicioni ka ndryshuar, nuk bëhet fjalë për pozicionin nr. 239, por bëhet fjalë për pozicionin nr. 238, të shpallur me vendimin e datës 02.05.2024, ku ka kandiduar kandidatja zonja {...}. Zonjës {...} i është hapur procedura dhe është filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore. Është marrë një vendim për kualifikimin e saj. Vendimi është marrë nga Këshilli me nr. 409, datë 30.07.2024 dhe është vendosur kualifikimi i kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 të vitit 2024, të Këshillit.

Më tej, pasi është bërë kualifikimi i saj dhe pa përfunduar të gjitha procedurat e lëvizjes paralele për pozicionin nr. 238, të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor pra nr. 238/2024, znj. {...}, më datë 23.09.2024 paraqiti me shkrim një kërkesë përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor ku ka kërkuar heqjen dorë nga kandidimi në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionin nr. 238/2024.

Në rrethanat e mësipërme përgatitet edhe relacioni kur vijimi i procedurës mbetet pa objekt për sa kohë është tërhequr kërkesa nga kandidatja zonja {...}.

Në këtë pikë Komisionit do t’i propozojë Këshillit përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, për kandidatin znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi. Propozimi mbështetet në pikën 29, Seksioni Ç, Kreu IV, të vendimit të Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, si dhe në vendimin nr. 320/2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, për kandidatin znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, për kandidatin znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 datë 02.05.2024, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Priti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.*
- 6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data (prezent vetëm në një pjesë të mbledhjes – deri në 13:20).*
- 7. Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 datë 02.05.2024, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 8 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, për kandidatin z.

{...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Zoti {...} ka paraqitur një kërkesë, ndër të tjera, ku ka shfaqur interes për të kandiduar në pozicionin e hapur me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 238, datë 02.05.2024, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile, shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (*në vijim Këshilli*).

Më tej ka filluar procedura për verifikimin e kriterëve ligjore, referuar nenit 48 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Fillimisht me vendimin nr. 298, datë 05.06.2024 të Këshillit është vendosur fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë dhe gjykatës administrative. Më tej, është caktuar si relator në verifikimin e kriterëve ligjore për fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore, z. Klodian Kurushi, pra jam caktuar unë si relator i verifikimit të kriterëve. Më tej në përfundim të procedurës së verifikimit, filloi dhe përfundoi procedura e verifikimit, Këshilli me vendimin nr. 414, datë 30.07.2024 vendosi kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024.

Në vijim të procedurave, më datë 20.09.2024 kandidati z. {...} ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 238, datë 02.05.2024, në fushën e së drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, protokolluar kjo kërkesë në Këshill me aktin nr. 4524, datë 20.09.2024.

Ndodhur në këto kushte, referuar vendimit të Këshillit nr. 320, datë 17.09.2024 (2020), pika 29, Seksioni Ç, Kreu IV, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele”, si dhe në vendimin nr. 320/2020, ne si Komision i propozojmë Këshillit përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me

46

vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion, pasi procedura mbetet pa objekt referuar kërkesës së heqjes dorë prej këtij kandidati.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 datë 02.05.2024, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024”. (relator z. Albens Tabaku)¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 12-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Pritfi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.**
- 6. Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024”. (relator z. Albens Tabaku).

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të kësaj mbledhjeje, pika 9, 10, 11, dhe 14, për shkak të karakterit të tyre, do të trajtohen në një moment të dytë të kësaj mbledhjeje. Vazhdojmë me pikën 12 të saj (*i referohet rendit të shpërndarë*), që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Tabaku.

Albens Tabaku: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024”.

Me shpalljen e pozicionit të lirë në fjalë, zoti {...} ka paraqitur interes sepse me vendimin nr. 260, të datës 16.05.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile.

Afati i kandidimit për këto procedura u përcaktua deri më datë 30.05.2024.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 260, datë 16.05.2024 shfaqti interes kandidati z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurën e lëvizjes paralele, mbështetur në pikën 9, të vendimit nr. 260/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 297, datë 05.06.2024, Këshilli ka miratuar edhe listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit të lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë, Fier, si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 233, 234, 235, 236, deri në 243, datë 02.05.2024 (me numër rendor, që mos i lexoj të gjitha), si dhe nr.260, datë 16.05.2024. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Me vendimin nr. 507, datë 24.09.2024, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore, pra tre kriteret formale.

Më datë 26.09.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele”, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure

verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit ose të çdo anëtari të Komisionit apo të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Brenda afatit të parashikuar më sipër, kandidati nuk parashitroi asnjë pretendim për asnjë nga të sipërpërmendurit, kështu që Komisioni vazhdoi me procedurën.

Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidatin z. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, si dhe të “mospasjes së papajtueshmërisë ambientale”.

Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, informacioni u kërkuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ku është kërkuar informacioni dhe ky informacion është përcjellë nëpërmjet postës elektronike të datës 19.09.2024.

Nga rezultatet e verifikimit të kritereve të kandidimit, për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”.

Pas verifikimit të kandidatit, në lidhje me plotësimin e kriterit sipas rastit konkret gjen mbështetje në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit 260/2024, dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë pune profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”.

Në lidhje me përvojën profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ka përvojë në seksionin penal. Sipas informacionit nga departamenti përkatës, z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 16.07.2013, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë penale”, njëkohësisht ka përfunduar edhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015. Me vendim nr. 298, datë 20.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. 332, datë 22.07.2022 të Këshillit të

Lartë Gjyqësor caktohet si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr. 131, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier” (pra me riformatimin e gjykatave) nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Vjetërsia, pra në rastin konkret, në funksionin të magjistratit është 2 vite. Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ai ka gjykuar në seksionin civil të kësaj gjykate.

Ndërsa me vendimin 31.10.2023, të Këshillit të Gjykatës, z. {...} vazhdon të gjykojë në seksionin civil të kësaj gjykate.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, të z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit. Pra në rastin konkret e plotëson.

Për sa i përket kriterit tjetër të mospasjes masa disiplinore në fuqi është verifikuar edhe ky kriter (që të mos citoj bazën ligjore që është e njohur). Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, z. {...} nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi.

Po kështu është verifikuar edhe kriteri për “papajtueshmërinë ambientale” (që të mos citoj përsëri bazën ligjore), është verifikuar nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Pra duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak nga komisioni në fjalë, pra nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për kandidatin z. {...} në lidhje me të tria kriteret ligjore, të shpallura me vendimin e Këshillit nr. 260, datë 16.05.2024, duke e vlerësuar të plotë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, i propozoj Këshillit, pra anëtarëve të nderuar, për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës për pozicionin e lirë në fushën e

të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Faleminderit z. Tabaku!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024”. (relator z. Albens Tabaku).²

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 13-ta sipas rendit të ditës. Shih hyrjen në procesverbalin e pikes 9.

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.

6. Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024”. (relator z. Albens Tabaku).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Tabaku.

Albens Tabaku: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Atëherë jemi në të njëjtën situatë të ngjashme si në rastin e parë, ku Komisioni ka përgatitur projektvendimin “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pasi Komisioni verifikoi, unë si relator dhe njësia mbështetëse ka verifikuar gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e të tria kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele të kandidatit në fjalë. Afati i kandidimit për këtë procedurë të lëvizjes paralele u përcaktua deri në datë 30.02.2024.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë të sipërpërmendur kandidoi edhe z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në Shkodër.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurën e lëvizjes paralele, nuk ka pasur ndonjë kundërshtim nga z. {...}.

Në rastin konkret, Këshilli vlerësoi, Komisioni i Etikës vlerësoi edhe rastin nëse ka dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarit që mund të mos ketë vlerësim fare.

Duke pasur parasysh që në vijim me vendimin nr. 507, datë 24.09.2024, Këshilli ka vendosur: “1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 260 datë 16.05.2024.

Më datë 26.09.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit, kandidati u njoftua. Brenda afatit ligjor ai kishte të drejtën për të kundërshtuar relatorin, anëtarët e Komisionit apo të ndonjë anëtari tjetër të Këshillit brenda 3 ditëve nga marrja e njoftimit, i cili është njoftuar pra në mënyrë elektronike. Brenda këtij afati të përcaktuar, kandidati nuk parashtrroi asnjë lloj pretendimi për sa më sipër. Kështu që në vijim të procedurës, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit nr.320/2020, përmes shkresave të veçanta, u kërkua për kandidatin në fjalë dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale specifike”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, si dhe në rastin e “papajtueshmërisë ambientale”.

Nga të gjitha informacionet e mbledhura, rezultatet e verifikimit të kandidatit në fjalë rezultoi që:

Përvoja profesionale specifike, pra kriteri i parë për lëvizjen paralele të gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka gjetur reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit 260/2024, ku përcaktohet që ai duhet të ketë të paktën 1 vit përvojë profesionale në fushën përkatëse.

Pas verifikimit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, rezultoi që sipas informacionit dhe dokumentacionit nga Departamenti i Burimeve Njerëzore z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 29.07.2011, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2022. Me vendimin nr. 100, datë 06.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 152, datë 29.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar si gjyqtar në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Më pas me vendimin nr. 136, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”, nga data 01.05.2023 ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Vjetërsia në funksionin të magjistratit është 1 vit. Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Kështu që, pasi janë verifikuar edhe këto kritere, nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë, rezulton që kandidati në fjalë të ketë mbi 1 vit përvojë profesionale.

Nuk ka masa disiplinore në fuqi. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet... Pra kemi rastin edhe të plotësimit të kriterit të tretë që është “papajtueshmëria ambientale”. Pasi është verifikuar edhe ky kriter, rezulton që nuk kemi pra rastin e papajtueshmërisë ambientale. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk është ndodhur në këtë situatën, në rastin e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në Elbasan.

Pra duke vlerësuar të plotë këtë procedurë verifikimi, për kandidatin z. {...}, në lidhje me kriteret ligjore për lëvizjen paralele, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 260, datë 16.05.2024, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Elbasan, ne pra si Komision, unë si relator propozoj për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Tabaku!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave

të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional (relatore znj. Emona Muçi).³

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 6. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 15-ta sipas rendit të ditës. Shih hyrjen në procesverbalin e pikes 9.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Ridvan Hado*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.*
6. *Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional (relatore *znj. Emona Muçi*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional. Për më tej fjalën relatores *znj. Muçi*.

Emona Muçi: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 25 të ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016” si dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ka si detyrë të fillojë procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Ndër gjyqtarët që kanë kaluar me sukses këtë proces është edhe znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me shkresën nr.{...} prot, datë 27.05.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, protokolluar me nr. {...} prot., datë 28.05.2024, është dërguar dosja e gjyqtares {...}, së bashku me aktet e vlerësimit profesional, si dhe vendimi nr. 732, datë 15.01.2024 që ka vendosur konfirmimin e saj në detyrë të gjyqtares të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vendim i cili ka marrë formë të prerë, pasi ndaj tij nuk është ushtruar e drejta e ankimit.

Pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe dokumentacionit të dosjes personale të gjyqtares, ka rezultuar se: znj. {...} në periudhën tetor 2012 - shtator 2015 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga tetori 2014 deri në muajin gusht 2015 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin e Presidentit nr. 9651, datë 23.06.2016 ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

Sa më sipër, rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, znj. {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtares në dy periudha:

(i) Praktikën profesionale të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës nga muaji tetor 2014 deri në muajin gusht 2015, për një kohëzgjatje prej 11 muajsh;

(ii) Funkcionin e gjyqtares për periudhën 23.06.2016 deri më 13.10.2016, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 20 ditë.

Sa i përket periudhës së stazhit profesional aktiv, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, referuar kuadrit ligjor të kohës, ligjit nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, në nenin 14 të tij parashikonte se:

“Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga:

a) Një vit programi teorik me lëndë të ndryshme të së drejtës;

b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori me kualifikim të lartë;

c) një vit praktik aktiv me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional).

Programi teorik sipas germës a) të nenit 14 është i përbashkët për të gjithë kandidatët, ndërsa viti praktik dhe stazhi zhvillohen sipas profileve që ka zgjedhur kandidati si gjyqtar ose prokuror...”.

Gjithashtu në nenin 19 të po këtij ligji, parashikohej se:

“Në përfundim të periudhës së parashikuar në shkronjën "b" të nenit 14 të këtij ligji, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i Republikës, me propozimin, përkatësisht, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.”

Lidhur me vlerësimin e vitit të tretë, në nenin 20, paragrafi i parë i ligji, parashikohej se: “Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve bëhet nga këshilli pedagogjik, në bazë të rezultateve teorike dhe praktike të stazhit”.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, rezulton se periudha e stazhit profesional, e cila përbente vitin e tretë të Shkollës së Magistraturës, ka qenë pjesë e Programit të Formimit Fillestar dhe për pasojë, vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtarit gjatë kësaj periudhe të ushtrimit të detyrës, i është nënshkruar vlerësimi profesional nga Shkolla e Magistraturës, në kuadër të vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, në përfundim të programit të formimit fillestar. Për pasojë, kjo periudhë e veprimtarisë profesionale nuk mund të bëhet objekt i një vlerësimi të dytë etik dhe profesional nga ana e Këshillit.

Lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës, pas emërimit të znj. {...}, në përfundim të programit të formimit fillestar, në raport me periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 2013-2016, rezulton se ajo ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, për periudhën 23.06.2016 deri në datë 13.10.2016, (pra periudhë 3 muaj e 20 ditë). Edhe nëse vitin 2016 do ta konsiderojmë vit të plotë pune për efekt të periudhës së vlerësimit, kohëzgjatja e detyrës së gjyqtares përkon me 6 muaj e 7 ditë.

Referuar nenit 84, pika 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin, sa i përket periudhës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, parashikohet se:

“1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar.

2. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat...”.

Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, lidhur me periudhën e vlerësimit, në nenin 5, parashikohet se:

“1. Për çdo gjyqtar përcaktohet periudha e vlerësimit në bazë të viteve të përvojës profesionale sipas parashikimeve të nenit 84, pikat 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin.

2. Periudha e lejes së papaguar nuk llogaritet si përvojë profesionale për efekt të përcaktimit të periudhës së vlerësimit.

3. Periudha e vlerësimit përbëhet nga vite kalendarike dhe fillon në datën 1 janar të vitit të parë të periudhës së vlerësimit.

4. Gjatë periudhës së vlerësimit, tre ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit”.

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor si më sipër, për znj.{...}, në kushtet kur rezultoi se koha e ushtrimit të detyrës që përfshihet në periudhën 2013-2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi, në kuptim të neneve 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, është më e shkurtër se një vit, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 4 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019, procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 3-vjeçare që përfshin vitet 2013-2016, nuk mund të fillojë. Përcaktimi i këtij kufiri kohor minimal 1-vjeçar, është miratuar nga Këshilli, për të mundësuar kryerjen efektive të vlerësimit me të dhëna dhe materiale të nevojshme për vlerësim.

Sa më sipër, në kushtet kur gjyqtarja pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, nuk rezulton të ketë ushtruar veprimtarinë profesionale për një kohëzgjatje minimale prej një viti, brenda periudhës së vlerësimit 2013-2016, procedura e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) është e pamundur të

fillojë, për sa kohë që nuk plotësohet kushti i përvojës së punës/kohës së ushtrimit të detyrës së gjyqtarit.

Sipas nenit 97, pika 3 i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikon: “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”. Ndërkohë në nenin 41 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë. 2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecion të organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur: a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës; b) situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e interesit publik. 3. Procedura administrative konsiderohet e filluar: a) me kryerjen e çdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e procedurës së filluar kryesisht; ose b) me paraqitjen e kërkesës.

Në zbatim të nenit 41 të K.Pr.Administrative që rregullon rastet dhe mënyrën e fillimit të një procedimi administrativ, në lidhje me nenin 171 pika 5 të Ligjit “Për Statusin”, procedura administrative me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët e konfirmuar me vendim të formës së prerë, fillon nga Këshilli në mënyrë të detyrueshme sipas ligjit, në rast se plotësohen:

1) Gjyqtari të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, duke u konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë;

2) Periudha e stazhit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar;

3) Koha/periudha e punës si gjyqtar me qëllim gradimi të jetë jo më pak se një vit.

Në rastin konkret, me konstatimin paraprakisht të mungesës së kushteve për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, sipas parashikimeve të nenit 171/5 të Ligjit për Statusin, për gjyqtaren {...}, vlerësohet se procedura e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtares për periudhën 2013-2016, nuk mund të fillojë, në kushtet kur koha e ushtrimit të detyrës që përfshihet në periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përbën periudhën e plotë vlerësimi në kuptim të nenit 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, është më e shkurtër se një vit.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet mosfillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtares {...}, për periudhën 2013-2016, pasi koha e ushtrimit të detyrës, brenda periudhës së vlerësimit, është më e shkurtër se një vit.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për mosfillimin e procedurës së vlerësimit t'i njoftohet gjyqtares {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë ndaj këtij akti administrativ individual të Këshillit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit znj. Muçi!

Ju bëj me dije që zoti Hado në vijim të kësaj pike dhe më tej nuk do jetë prezent në këtë mbledhje plenare për shkak të një programi të programuar kohë më parë në lidhje me axhendën e tij profesionale, për shkak të angazhimeve që ka.

Keni diskutime për sa u prezantua?

(Nuk ka diskutime.)

Nuk keni diskutime. Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.⁴

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 6. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 16-ta sipas rendit të ditës. Shih hyrjen në procesverbalin e pikes 9.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Ridvan Hado*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.*
6. *Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën Drejtoreshës, zonjës Ngucaj.

Blerta Ngucaj: Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 91, pika 3 e ligjit nr.115/2016, i ndryshuar, me vendimin nr. 280, datë 10.12.2019, të ndryshuar disa

herë, ka vendosur caktimin e gjyqtarëve, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat në gjykatat e apeleve dhe në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm si dhe në ato të posaçme.

Gjyqtarja {...}, e caktuar si Gjyqtar për Median në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ishte kandidatë për transferimin e përkohshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli.

Pas përmbylljes së procedurës për transferim të përkohshëm në këtë gjykatë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e tij nr. 432, datë 31.07.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 477 të po të njëjtës datë ka vendosur:

“1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarës znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.”.

Efektet juridike të këtij vendimi filluan më datë 11.09.2024.

Në vijim, pranë Këshillit është administruar me aktin nr. {...} prot., datë 30.09.2024, shkresa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me nr. {...} prot., datë 24.09.2024, mbi propozimin për caktimin e një gjyqtari për mediat pranë kësaj gjykate. Nëpërmjet kësaj shkrese gjykata ka bërë me dije, Zëvendëskryetari i gjykatës, ka bërë me dije, se pas konsultimit me trupën gjyqësore të kësaj gjykate ka propozuar: “1. Caktimin në pozicionin e gjyqtarit të medias në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, të znj. {...}.”

Me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimit kushtetues për informimin e publikut në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, në zbatim të nenit 91 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe vendimit nr. 590 datë 26.11.2020 “Për miratimin e Planit Strategjik të Komunikimit për sistemin gjyqësor”, të Këshillit, ka përgatitur projektvendimin “Për ndryshimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e Gjyqtarëve për Mediat” i ndryshuar.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet ndryshimi i pikës 1 të vendimit nr. 280, datë 10.12.2019 “Për caktimin e Gjyqtarëve për Mediat”, duke zëvendësuar gjyqtarin për

mediat në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, znj. {...} me gjyqtaren znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se ngarkohet Gjyqtari për Mediat i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, të marrë masat për zbatimin e këtij vendimi.

Së fundi, përcaktohet dhe hyrja në fuqi menjëherë e vendimit dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Faleminderit znj. Ngucaj!

Keni diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Në pikën 1 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019 “Për caktimin e Gjyqtarëve për Mediat”, i ndryshuar me vendimet nr. 292, datë 06.07.2021; nr. 424, datë 29.09.2021; nr. 254, datë 07.07.2022; nr. 515, datë 21.11.2022, nr. 101, datë 06.03.2023; nr. 662, datë 02.11.2023 dhe nr. 248, datë 02.05.2024, nr. 272, datë 29.05.2024 dhe nr. 420, datë 30.07.2024 gjyqtari për mediat në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, znj. {...} zëvendësohet në këtë detyrë nga gjyqtarja znj. {...}.

2. Ngarkohet Gjyqtari për Mediat i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë të marrë masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2024-2025”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.⁵

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 6. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 18-ta sipas rendit të ditës. Shih hyrjen në procesverbalin e pikes 9.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Ridvan Hado*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerita Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala (në sallë), përfaqësuese EWMI.*
6. *Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2024-2025”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Atëherë në vijim, po vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2024-2025”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatores *znj. Rupa*.

Yllka Rupa: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Po paraqes në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit relacionin mbi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2024-2025”.

Mbështetur në kompetencat kushtetuese dhe ligjore, Këshilli pasi ka përcaktuar numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2024-2025 ka përcaktuar edhe numrin e ndihmësve ligjorë që do të pranohen në formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, pas përfundimit me sukses të provimit të pranimit dhe janë në masën e 15 kandidatëve.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve në kuadër të rekrutimit, përfshirë edhe të atyre që do të fillojnë formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose ndihmës ligjor”. Ky vendim parashikon se Këshilli zhvillon procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët.

Kandidati fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës.

Procedura e verifikimit fillon me vendimin e Këshillit, jo më vonë se 7 ditë nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të listës së kandidatëve fitues në provimin e pranimit për në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit.

Në pikën 62 të vendimit përcaktohet se në të njëjtin vendim për fillimin e verifikimit, Këshilli cakton, me short, relatorin për çdo kandidat.

Në zbatim të këtij rregulli, është e nevojshme vendimmarrja e Këshillit për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për formimin fillestar për ndihmës ligjor, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ky Komision bazuar në vendimin e Këshillit nr.601, datë 23.12.2021, të ndryshuar ka në përbërje të tij znj. Llagami, z. Hado dhe unë Yllka Rupa. Referuar pikës 2, të nenit 63, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes”, znj. Llagami, njëkohësisht Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të jetë relatore në procedura në të cilat Komisioni ose Këshilli duhet të miratojnë akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose nëpunësve civilë gjyqësorë.

Lidhur me procedurën e shortit, propozojmë të ndiqen të njëjtat rregulla të ndjekura edhe më parë nga Këshilli në procedura të tilla, ku në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e 2 anëtarëve të Komisionit të Planifikimit pra z. Hado dhe znj. Rupa, ndërsa në enën tjetër të hidhen shiritat e letrës me emrat e 11 kandidatëve.

Për lehtësi të procedurave të organizimit të shortit, duhet ndjekur këto hapa:

Fillimisht vijohet me tërheqjen e një prej shiritave të letrës.

Është e nevojshme të shpjegoj procedurat?

S’është e nevojshme.

Për sa i takon strukturës së projektvendimit.

Lidhur me strukturën, në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës, për kandidatët fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025, për profilin ndihmës ligjorë.

Pika 2 të projektvendimit caktohet relatori për secilin nga 11 kandidatët për të cilët fillon procedura e verifikimit.

Ndërsa, në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet detyrimi i njoftimit të vendimit kandidatëve.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u relatua edhe në lidhje me mekanizmin e hedhjes së shorti?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, atëherë ftoj administratën të përgatisë hedhjen e shortit sipas mekanizmit të prezantuar nga relatorja.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë vendosen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve: z. Ridvan Hado, znj. Yllka Rupa.

Në enën e dytë vendosen shiritat e letrës me emrat e ndihmësve ligjorë: z. {...}, 2. znj. {...}, 3. znj. {...}, 4. znj. {...}, 5. z. {...}, 6. z. {...}, 7. z. {...}, 8. z. {...}, 9. znj. {...}, 10. znj. {...}, 11. znj. {...}.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Anëtari i parë i përzgjedhur si relator për gjashtë kandidatë është z. Ridvan Hado. Zoti Hado do të jetë relator për ndihmësit ligjorë të përzgjedhur sipas kësaj radhe: z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Anëtarja e dytë e përzgjedhur si relatore për pesë kandidatë është znj. Yllka Rupa. Zonja Rupa do të jetë relatore për ndihmësit ligjorë të përzgjedhur sipas kësaj radhe: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Keni diskutime mbi mënyrën e hedhjes së shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk keni diskutime, atëherë kalojmë në votimin e projektvendimit të përditësuar me të dhënat që rezultuan nga shorti i sapo hedhur.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në

provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2024-2025”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025, për profilin ndihmës ligjor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për z. {...} - relatore znj. Yllka Rupa.
2. Për znj. {...} - relatore znj. Yllka Rupa.
3. Për znj. {...} - relator z. Ridvan Hado.
4. Për znj. {...} - relator z. Ridvan Hado.
5. Për z. {...} - relator z. Ridvan Hado.
6. Për z. {...} - relator z. Ridvan Hado.
7. Për z. {...} - relator z. Ridvan Hado.
8. Për z. {...} - relator z. Ridvan Hado.
9. Për znj. {...} - relatore znj. Yllka Rupa.
10. Për znj. {...} - relatore znj. Yllka Rupa.
11. Për znj. {...} - relatore znj. Yllka Rupa.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve, të përfshirë në pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, pak pushim për të diskutuar dhe për të qenë më efektivë në pikat që kemi për diskutim në vijim.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.⁶

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 17-ta sipas rendit të ditës. Shih hyrjen në procesverbalin e pikes 9.

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

3. Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.

4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

(Rifillon mbledhja pas disa minutash pushim, ora 14:15.)

Ilir Rusi: Atëherë në vijim, të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke marrë në konsideratë edhe tipologjinë e çështjeve të cilat ishin për shqyrtim në këtë mbledhje, njëkohësisht edhe dinamikës së lëvizshmërisë të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ju bëj me dije që zoti Hado tashmë është prezent në këtë mbledhje për shkak se i ka përfunduar në një kohë rekord angazhimet e veta, vazhdojmë me këtë mbledhje. Për shkak edhe të krijimit të kuorumit edhe të ekzistencës së kuorumit të

82

nevojshëm për të vazhduar mbledhjen e mëtejshme, vazhdojmë me një pikë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Së fundmi zoti Xhoda është në gjendje për të na dhënë shpjegimet e veta në lidhje me relacionin përkatës.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijeni, me ligjin nr. 97/2024 “Për buxhetin e vitit 2024”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2024, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor ”Këshilli i Lartë Gjyqësor”, për të tre programet buxhetore.

Me vendimin nr. 743, datë 28.12.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka detajuar fondet buxhetore për vitin buxhetor 2024, për të gjithë sistemin, për të tre programet buxhetore, ku në programin “Buxheti Gjyqësor”, për gjykatat e të gjitha niveleve, janë detajuar fonde në shumën 4,569,000 mijë lekë, të cilat janë në shpenzime paga, shpenzime në sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime kapitale.

Fondi i detajuar në programin 03310 në shpenzime personeli është në shumën 3,579,700 mijë lekë, nga të cilat shuma 3,451,050 mijë lekë iu janë detajuar gjykatave si njësi shpenzuese më vete, ndërsa fondi prej 128,650 mijë lekë, u administrua në KLGJ 03310. Ky fond u administrua në KLGJ 03310 me qëllim financimin ose detajimin e fondeve për pagat e 32 magistratëve të rinj të cilët erdhi momenti që kanë filluar, janë caktuar nëpër gjykatat respektive dhe këto para do t’i përdorim për plotësimin e nevojave të tyre sipas strukturave organizative të gjykatave.

Me vendimin nr. 543, datë 01.10.2024 “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 31.07.2024, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2021-2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me vendimet nr. 553 - 584, datë 02.10.2024 “Për caktimin në pozicion të gjyqtarit të emëruar” (secilit prej gjyqtarëve), të Këshillit të Lartë Gjyqësor, 32 magistratët e rinj përfunduan Shkollën e Magistraturës u caktuan për ushtrimin e funksionit në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Pas vendimmarrjes së Këshillit, në bashkëpunim me gjykatat respektive, Departamenti i Buxhetit, kreu një analizë buxhetore në lidhje me nevojat e gjykatave për fonde në shpenzime personeli, dhe në përfundim të kësaj analize vlerësojmë rishpërndarjen e fondeve në shpenzime personeli për të përballuar efektin financiar të të caktimit të gjyqtarëve të rinj në këto gjykata, sipas pasqyrës nr.1 dhe nr.2, respektivisht për në shpenzime paga dhe shpenzime sigurime shoqërore.

Ndërsa në lidhje me pagesën e trajtimit financiar të magjistratëve profili gjyqtar, të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024, tashmë Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur një praktikë të saj të vendimmarrjes, referuar vendimit nr. 719, datë 06.12.2023 “Mbi trajtimin financiar të magjistratëve (profili gjyqtarë), të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023” i cili ka miratuar trajtimin financiar të magjistratëve (profili gjyqtar), të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023, nga data 01.07.2023, në vazhdim.

Në këto kushte, duke marrë në konsideratë, si më poshtë:

(i) vendimin e sapo cituar më sipër të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi trajtimin financiar të magjistratëve të vitit akademik 2022-2023”;

(ii) praktikën gjyqësore të deritanishme të gjykatës ku në shumicën e rasteve ka vendosur detyrimin e KLGJ-së të trajtojë financiarisht të diplomuarit nga Shkolla e Magjistraturës, kandidatët gjyqtarë në formën e pagesës mujore ekuivalente me pagën bruto fillestare të magjistratit, për periudhën nga data e diplomimit deri në momentin e emërimit në pozicion;

(iii) për efekt të ekonomisë gjyqësore, me qëllim shmangien e proceseve gjyqësore të ngjashme të cilat sjellin shpenzimet të konsiderueshme në buxhetin e KLGJ-së (përmendim këtu ngarkimin me shpenzime gjyqësore, ku një peshë të madhe zënë shpenzimet përmbartimore të cilat përlllogariten në përqindje sipas vlerës së detyrimit, por edhe konsumim të burimeve njerëzore të KLGJ-së që duhet të marrin pjesë në seanca gjyqësore për shqyrtimin e këtyre çështjeve);

(iiii) si dhe në faktin se më lart vlerësuam për rishpërndarja e fondeve buxhetore, për vitin buxhetor 2024, në shpenzime personeli, ku është parashikuar trajtimi i këtyre magjistratëve të rinj për një periudhë gjashtëmujor;

vlerësojmë miratimin e pagesës së trajtimit financiar të magistratëve (profili gjyqtar), të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024, nga data e diplomimit e në vazhdim.

Po kështu, të nderuar anëtarë, dua t'ju bëj me dije se gjatë kësaj periudhe të vitit buxhetor, nga disa gjykata, kanë ardhur disa kërkesa për fonde shtesë në shpenzime operative, të cilët ju, ju është bërë me dije në relacionin në seancën plenare të datës 25.09.2024, ku disa nga gjykatat kanë paraqitur nevojat për fonde shtesë në shpenzime për “Mallra dhe Shërbime të tjera (operative)”, në shumën 188,393 mijë lekë. Por për mos disponim fondesh të lira, në mbledhjen e kaluar u detajuan vetëm 6,000 mijë lekë.

Kërkesat për fonde shtesë të ardhura nga gjykatat, janë argumentuar për shlyerjen e detyrimeve për energji elektrike, shërbime postare, blerje kuti arkive, shërbim avokatie dhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, ku ky lloj shpenzimi, detyrimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, zë pjesën më të madhe kërkesave buxhetore dhe kanë lidhje më tepër me pagat e administratës gjyqësore.

Në këto kushte, kur pas plotësimit të nevojave për fonde në shpenzime personeli, disponohen fonde të lira në këtë grup shpenzimi, vlerësojmë transferimin e tyre nga shpenzime personeli (600, 601) në shpenzime për “Mallra dhe Shërbime të tjera (operative) (602), në shumën 132,728 mijë lekë, sipas pasqyrës nr. 3, bashkëlidhur.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit dhe projektvendimin mbi rishpërndarjen e fondeve buxhetore, programi 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601, 602), për vitin buxhetor 2024, në nivel artikulli dhe njësie shpenzuese, sipas pasqyrave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur si dhe pagesën e trajtimit financiar të magistratëve (profili gjyqtar), të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024, nga data e diplomimit e në vazhdim.

Duke ju falenderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Ju faleminderit edhe një herë.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Haxhiu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Vetëm një diskutim për mënyrën se si mund të formulohet projektvendimi referuar pikës 2. Është propozuar: “2. Miratimin e pagesës së trajtimit financiar të magjistratëve (profili gjyqtar), të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024, nga data e diplomimit e në vijim”.

Referuar edhe asaj çfarë u konsultuam me materialet e vitit të kaluar, për të ruajtur edhe standardin që ne kemi vendosur si Këshill vitin e kaluar, për sa kohë situatat dhe rrethanat janë të njëjta, nuk ka ndryshuar asgjë, as nuk është zvogëluar ndonjë rrethanë, as nuk është shtuar ndonjë gjë e re, mendoj për të ndjekur të njëjtin standard, mendoj të caktohet vetëm data siç e kemi caktuar vitin që kaloi, pra nga “data e diplomimit”, si fjalë, të zëvendësohet me fjalën “nga data 01.07.2024 e në vazhdim” – mendoj. Referuar standardit tonë. Ky është komenti edhe më pas nëse juve keni ndonjë propozim në lidhje me këtë çfarë them unë.

Ilir Rusi: Atëherë, fjala për ju zoti Haxhiu!

Xhevdet Haxhiu: Në propozimin tonë si Departament por edhe propozimi i Komisionit, mbajtëm standardin e vjetshëm të propozimit të Këshillit. Por vendimmarrja u kompletua në seancë plenare. Megjithatë unë jam shumë dakord me përcaktimin e bërë nga zoti Kurushi.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Atëherë, cili është perifrasi i pikës 2 zoti Haxhiu?

Xhevdet Haxhiu: I nderuar z. Zëvendëskryetar, përkufizimi i pikës 2 ndryshon: “2. Miratimin e pagesës së trajtimit financiar të magjistratëve (profili gjyqtar), të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024, nga data 01.07.2024 e në vazhdim.”.

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të relatimit, diskutimeve dhe referimit fundor, pika 2 ndryshohet nga “data e diplomimit e në vazhdim”, në nga “data 01.07.2024 e në vazhdim”. Keni diskutime?

Nuk ka diskutime. Vazhdojmë në votimin e projektvendimit të përditësuar sipas propozimit fundor të bërë nga zoti Haxhiu.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Unë jam kundër pagesës që nga momenti i diplomimit nga Shkolla e Magjistraturës për shkak të praktikës time gjyqësore, në të cilën kam vendosur nga data 01.08, që është data e përfundimit të afatit njëmuajor që ka KLGJ-ja në dispozicion për emërimin e magjistratëve.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601 dhe 602), për vitin buxhetor 2024, sipas pasqyrave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

2. Miratimin e pagesës së trajtimit financiar të magjistratëve (profili gjyqtar), të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024, nga data 01.07.2024 e në vazhdim.

3. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 15 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).⁷

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |

⁷ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës. Shih hyrjen në procesverbalin e pikes 9.

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

15. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim bëj me dije që zonja Muçi u largua për arsye personale.

Do vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga

90

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, dhe relator është z. Koça. Për më tej fjalën z. Koça.

Markelian Koça: Po, faleminderit z. Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ju paraqet projektvendimin e cituar nga Zëvendëskryetari. Në relacionin bashkëlidhur ju bëj me dije se me vendimet nr. 489-nr.493, datë 13.09.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale.

Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit ka qenë data 20.09.2024.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.490, datë 13.09.2024 ka kandiduar z. {...} gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për të marrë pjesë në këtë proces, bazuar në pikën 9, të vendimit 490/2024 mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 506, datë 24.09.2024, Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Me vendimin nr. 520, datë 24.09.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 489, nr.490, nr.491, nr.492 dhe nr.493, datë 13.09.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, është vendosur fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin nr. 490, datë 13.09.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim. Jam caktuar unë si relator për kandidatin {...}.

Në vijim, në datën 25.09.2024, është njoftuar elektronikisht kandidati në lidhje me fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit,

91

caktimin e relatorit, të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo anëtarëve të Këshillit brenda afatit treditör. Kjo e drejtë nuk është ushtruar nga kandidati, nuk janë paraqitur pretendime për relatorin apo anëtarët e Këshillit.

Në vijim është proceduar me kërkimin e informacionit nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organ kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Konkretisht është kërkuar informacion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe Elbasan, i cili është përcjellë dhe do të raportohet në vijim.

Konstatimet e komisionit dhe rezultatet e verifikimit të kriterëve të kandidimit.

Në lidhje me kriterin e “Përvojës profesionale specifike minimale”, referuar parashikimeve ligjore të ligjit “Për statusin” si edhe akteve të Këshillit, rezulton se magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë 5 viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë.

Rezulton që si shpallja dhe aplikimi për pozicionin nr.490 datë 13.09.2024 është në fushën e së drejtës civile, kërkohet që kandidati të ketë të paktën 1 vit përvojë profesionale në këtë fushë.

Në lidhje me përvojën profesionale të përgjithshme, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, rezulton se ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 20.07.2011, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë civile” në Universitetin të Tiranës në vitin 2013 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar gjyqtar dhe caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Me vendimin nr. 129, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, nga data 01.05.2023 ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Me vendim të Këshillit është transferuar përkohësisht pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Elbasan, për një periudhë 1 (një) vjeçare, e në vijim me vendimin nr. 216, datë 25.04.2024 të

Këshillit transferohet sipas procedurës së lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Elbasan, ku aktualisht ushtron funksionin.

Të dhënat e mësipërme konfirmohen edhe nga informacioni i përcjellë zyrtarisht nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kështu që nuk po i lexoj prapë nga e para për efekt kohe, meqenëse janë të njohura.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, nga verifikimet e kryera, rezulton se: “Pasi u njohëm me kërkesën tuaj për informacion për përvojën profesionale specifike si gjyqtar në fushën e drejtësisë civile të z {...}, ju bëj me dije se: Për periudhën korrik të vitit 2019 deri më tetor të vitit 2023, z {...} ka ushtruar detyrën si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, pasi në tetor 2023, është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Gjithashtu z. {...} ka gjykuar të gjitha kategoritë e çështjeve, konkretisht çështje civile, penale, familjare dhe tregtare, pasi Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk ka qenë e ndarë në seksione apo dhoma të veçanta penale dhe civile.”

Ndërsa nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është përcjellë shkresë, ku rezulton se nga verifikimet e kryera, z. {...} gjykon në seksionin civil sipas vendimit nr.4/1, 01.11.2023 të Këshillit të Gjykatës.

Pra nga gjithë dokumentacioni i administruar rezulton se ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile, ndërsa vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 vite dhe nuk ka masa disiplinore.

Në lidhje me masat disiplinore është administruar deklarimi i kandidatit se nuk ka masa disiplinore dhe po ashtu edhe nga konfirmimi nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit rezulton se nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë ambientale, si të gjithë procedurat e tjera referuar kërkesave të ligjit dhe vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor është administruar deklarata e kandidatit se nuk do të ndodhet në situatë papajtueshmëri ambientale sipas pikës 3 të nenit 8, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë verifikimit nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati.

Në këto kushte, duke u konsideruar i plotë dokumentacioni i mbledhur për kandidatin {...}, relatori i çështjes i ka përcjellë mbledhjes së komisionit aktet e çështjes në lidhje me pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490, 13.09.2024.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, më datë 26.09.2024, duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret ligjore të kandidimit të z. {...}, ka vendosur t’ia përcjellë mbledhjes plenare për shqyrtim vlerësimin dhe për të vendosur kualifikimin ose jo të z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490 datë 13.09.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 490 datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 15 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 16 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490 datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).⁸

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |

⁸ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 10-ta sipas rendit të ditës. Shih hyrjen në procesverbalin e pikes 9.

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

16. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490 datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490 datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit z. Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ju paraqesim projektvendimin e cituar nga Zëvendëskryetari. Në relacionin bashkëlidhur ju bëj me dije se me vendimet nr. 489- nr.493, datë 13.09.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale.

Afati i kandidimit ka qenë data 20.09.2024.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.490, datë 13.09.2024 ka kandiduar z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, aktualisht gjyqtar i komanduar në pozicionin “këshilltar juridik” në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për të marrë pjesë në këtë proces, bazuar në pikën 9, të vendimit 490/2024 mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 506, datë 24.09.2024, Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Me vendimin nr. 520, datë 24.09.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 489, nr.490, nr.491, nr.492 dhe nr.493, datë 13.09.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, ndër të tjera Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin nr. 490, datë 13.09.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që mund të kenë 1 (një) vlerësim. Në pikën 3 të rendit është përcaktuar emri i zotit {...} dhe sipas procedurës së shortit jam caktuar unë si relator i çështjes.

Në vijim, në datën 25.09.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” është njoftuar elektronikisht kandidati në lidhje me fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, caktimin e relatorit të procedurës së verifikimit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo anëtarëve të Këshillit brenda afatit treditör. Brenda afatit të përcaktuar nuk është parashtruar ndonjë pretendim nga kandidati e për pasojë në vijim ka nisur puna për mbledhjen e dokumentacionit nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykata ku kandidati ka ushtruar veprimtarinë si gjyqtar zoti {...}, që do të citohet në vijim.

Rezultatet e verifikimit të kriterëve të kandidimit.

Referuar përcaktimeve ligjore, për përvojën profesionale specifike, meqenëse kandidohet për një pozicion në fushën e së drejtës civile, mbahet parasysh përcaktimi i pikës 6, nenit 43 të ligjit “Për statusin” ku përcaktohet se magistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë 5 viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë.

Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 490 datë 13.09.2024, pra kërkohet 1 vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e të drejtës civile gjatë 5 viteve të fundit.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet fakti se ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, pranë Universitetit të Studimeve të Piemontes Orientale “{...}” në datë 21.10.2005, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në Universitetin e Torinos në vitin 2007 dhe ka përfunduar Shkollën e Magistraturës në vitin 2020. Me vendim të Këshillit emërohet dhe caktohet në pozicion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën tetor 2020-mars 2022 më pas komandohet në pozicionin “Këshilltar Juridik” në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me afat deri në 31.12.2024.

Konfirmohet sa më lart edhe nga dokumentacioni i përcjellë zyrtarisht. Shtoj vetëm në mënyrë të hollësishme në lidhje me faktin e emërimit.

Me vendimin nr. 518, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me vendimin nr. 121, datë 29.03.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet kërkesa për ushtrimin e veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Strasburg, me shkëputje nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit nga data 04.04.2022-01.07.2022. Me vendimin nr. 238, datë 30.06.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet kërkesa për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg, me shkëputje nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit nga data 02.07.2022-31.12.2022. Me vendimin nr. 549, datë 22.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet kërkesa për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Strasburg, me shkëputje nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit nga data 01.01.2023-31.12.2023. Me vendimin nr. 731, afati shtyhet deri në 31.12.2024. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite. Z. {...} nuk rezulton të ketë masa disiplinore.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është sjellë shkresë ku rezulton nga verifikimet e kryera se “Nga data 27.10.2020 është emëruar me vendimin nr.518 datë 27.01.2020 të KLGJ deri më datë 29.03.2022 ku me vendimin te KLGJ është transferuar pranë Gjykatës Evropiane (ato që thamë edhe më lart). Gjatë periudhës që ka ushtruar funksionet e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër) ka qenë pjesë e seksionit civil prej vitit 2021 dhe në vijim, si me poshtë: 1. Ka ushtruar funksionet e gjyqtarit duke qene pjesë trupës gjyqësore, Dhoma Civile konkretisht 10.11.2020 deri më 29.03.2022 (Vendim i datës 10.11.2020 i Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; Vendimi i datës 24.03.2021 i Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; Vendimi i datës 08.11.2021 i Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër)”.

Pra nga sa më lart rezulton që ka mbi një vit përvojë profesionale minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile.

Në lidhje me kriterin e mospasjes masë disiplinore është administruar vetëdeklarimi i datës 20.09.2024, se nuk ka masa disiplinore, situatë që konfirmohet

100

edhe nga informacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit për kandidatin {...}.

Po kështu edhe në lidhje me papajtueshmërinë ambientale është administruar deklarimi i kandidatit i datës 20.09.2024, nëpërmjet të cilit, kundrejt përgjegjësisë ligjore deklararon se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3 të nenit 8 të ligjit 96/2016 “Për statusin” dhe po ashtu edhe nga verifikimet e kryera nuk rezulton ndonjë e dhënë e ndryshme nga sa është deklaruar.

Në këto kushte, duke e konsideruar të plotë materialin, ia kam përcjellë mbledhjes së Komisionit, i cili me datën 26.09.2024, po ashtu e konsideron të plotë procedurën e verifikimit për kriteret ligjore të kandidimit të z. {...}, për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe ka vendosur përcjelljen mbledhjes plenare për të vendosur mbi kualifikimin apo jo të z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490 datë 13.09.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490 datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 490 datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 16 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 17 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).⁹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |

⁹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 11-ta sipas rendit të ditës. Shih hyrjen në procesverbalin e pikes 9.

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

17. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490 datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490 datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë!

Paraqes relacionin e radhës që i referohet projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490 datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Me vendimet nr.489 - nr.493, datë 13.09.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe në fushën e së drejtës penale.

Afati i kandidimit ishte deri më datë 20.09.2024.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.490, datë 13.09.2024 kandidoi edhe z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit të tyre në procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 490/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 506, datë 24.09.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose që mund të kenë një vlerësim etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}. Përfshihet z. {...} për pozicionin që i referohet vendimit nr. 490, datë 13.09.2024, të cilit mund t'i bëhet një vlerësim.

Me vendimin nr. 520, datë 24.09.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 489, nr.490, nr.491, nr.492 dhe nr.493, datë 13.09.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, dhe u caktuan relatorët përkatës për kandidatët që kishin shprehur interes në këto pozicione të lira. Për kandidatin z. {...} jam caktuar unë si relator.

Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralel”, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore; ii) caktimin e relatorit për procedurën e verifikimit të këtyre kriterëve; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja dijeni e këtij njoftimi.

Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit.

Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidatin z. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm që vlente për të bërë verifikimet e tre kriterëve ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Rezultatet e verifikimit.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, referuar kriterit të përvojës specifike minimale e kërkuar nga neni 43 i ligjit “Për statusin”, kandidati z. {...} rezultoi se ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, ka marrë titullin Jurist, pranë Universitetit “Luarasi” në datë 03.07.2007 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendimin nr. 468, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ai emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 520, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datë 14.07.2021 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datë 14.07.2022 rizgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe referuar vendimit nr. 141, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

106

Përgjithshëm Vlorë, datë 14.07.2023 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite. Zoti {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nga verifikimet e kryera, rezulton se: “Ne përgjigje të e-mailit tuaj ju informojmë për sa vijon, për gjyqtarin z. {...}: 1- Me vendimin nr. {...} Prot, datë 27.07.2021 ka qenë gjyqtar i gjykimit të çështjeve të përgjithshme (gjykimin e çështjeve penale & civile) 2- Me vendimin nr. {...} Prot, datë 14.09.2022 ka qenë gjyqtar i gjykimit të çështjeve të përgjithshme (gjykimin e çështjeve penale dhe civile) 3- Me vendimin e Këshillit të Gjykatës nr. {...} Prot, datë 14.11.2023, dhe ne vijim është gjyqtar i gjykimit të përgjithshëm i cili gjykon të të gjitha llojeve përveç atyre që gjykon seksioni i të miturve pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.”

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 490 datë 13.09.2024, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale në fushën e së drejtës civile.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore”.

Në lidhje me këtë kriter i cili është përcaktuar si i tillë në nenin 43 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga verifikimet ka rezultuar se kandidati ka depozituar formularin e vetëdeklarimit për masën disiplinore datë 19.09.2024, nëpërmjet të cilit, përkundëjt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

Njëkohësisht nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton se z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me kriterin e “papajtuëshmërisë ambientale”, kriter i cili gjen parashikim në nenin 8, pika 2 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve”, ka rezultuar se fillimisht referuar kësaj dispozite ligjore, kandidati ka depozituar formularin e vetëdeklarimit “Për situatën e papajtuëshmërisë ambientale” datë 17.09.2024,

nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nëse ai transferohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Njëkohësisht, përveç formularit të vertëdeklarimit të paraqitur nga kandidati, është bërë edhe verifikimi nga ana e Komisionit dhe gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...}, nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Kështu që, pasi kemi verifikuar të gjitha kriteret ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin nr. 490, të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor që i përket fushës të së drejtës civile, ne i propozojmë Këshillit kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin të cilin unë e përmenda më lart.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u prezantua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime për sa u relatua, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.490 datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 490 datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 17 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 18 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹⁰

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |

¹⁰ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 14-ta sipas rendit të ditës. Shih hyrjen në procesverbalin e pikes 9.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerita Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

2. *Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.*

3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*

5. *Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).*

6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

18. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Tiranë”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë hapur

procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Afati i kandidimit u përcaktua deri më datë 30.06.2023.

Branda afatit të kandidimit për këtë pozicion kandiduan 3 (tre) kandidatë: znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

Këshilli me vendimin nr. 297, datë 05.06.2024, miratoi listën e kandidatëve që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime/ 1 vlerësim/ pa vlerësim, për efekt të kandidimit në pozicionet e procedurave të lëvizjeve paralele, ndër to edhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin nr.260.

Në vijim duke qenë se kandidatja me një vlerësim (znj. {...}) u tërhoq nga ky pozicion, Këshilli me vendimin nr.507, datë 24.09.2024 vendosi: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 260/2024, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim. Caktimin e relatorit si më poshtë: Për kandidatin z. {...}, relator z. Albens Tabaku; Për kandidatin z. {...}, relator z. Albens Tabaku”.

Kandidatët u kualifikuan me vendimin e Këshillit që ne morëm ditën e sotme. Pra sot më datë 16 tetor 2024 morëm vendimin për kualifikimin e tyre.

Rrjedhimisht, me disa vendime të datës 13.09.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ndër to edhe për pozicionet nr. 489, 492, 493.

Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua data 20.09.2023.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, Këshilli me vendimin nr. 506/2024, miratoi listën e gjyqtarëve që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të përmendur më lart. Në këtë listë janë përfshirë gjithsej 5 (pesë) kandidatë që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime.

Në vijim, me vendimin nr. 520, datë 24.09.2024 Këshilli vendosi: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve

paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 489, nr.491 nr.492 dhe nr.493, datë 13.09.2024, për kandidatët që kanë ose mund t'i bëhen dy vlerësime.”.

Në pozicionin nr. 489 kandidati i vetëm me dy vlerësime është z. {...}. Është me dy vlerësime sepse është vlerësuar dhe kanë kaluar dy vlerësimet nga Këshilli. Këshilli me vendimin nr. 599, datë 09.10.2024, ndër të tjera vendosi: “Kualifikimin e z.{...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 489, datë 13.09.2024.”.

Në pozicionin nr. 492/2024 kandidat i vetëm me dy vlerësime është z. {...}. Këshilli me vendimin nr.533, datë 26.09.2024 vendosi: “Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimet nr. 492 dhe nr. 493.

Në pozicionin nr. 493/2024 kandidatë me dy vlerësime janë znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}. Ata janë kualifikuar nga Këshilli me vendimet nr. 533, nr. 531 dhe nr. 532, datë 26.09.2024.

Sa më sipër, rezulton që në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Tiranë, të ketë kandidatë të kualifikuar për transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele, ku shumica e të cilëve kanë kandiduar për tre pozicione të lira, në bazë të së drejtës së dhënë nga ligji, pika 5, e nenit 43 të Ligjit për Statusin.

Në vendimin nr. 320/2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, pika nr. 75 e Kreut VI parashikohet: “Procedura e përzgjedhjes fillon menjëherë pas përfundimit me vendim të formës së prerë të verifikimit të të gjithë kandidatëve dhe, kur është rasti, edhe të vlerësimit etik dhe profesional të tyre. 76. Në procedurën e përzgjedhjes përfshihen të gjithë kandidatët e kualifikuar.”

Deri tani ne prezantuar kandidatët e kualifikuar për pozicionet që ne do propozojmë fillimin e procedurës së përzgjedhjes së tyre.

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për

lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Tiranë për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 260/2024; nr.489, 492, 493/2024”.

Po ashtu, sipas këtij projektvendimi Këshilli do të duhet të përcaktojë relatorin për çdo procedurë përzgjedhjeje për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele.

Lidhur me këtë situatë, sipas projektvendimit Komisioni ka vlerësuar që në rrethanat kur janë katër pozicione të lira, është propozuar që secili nga anëtarët e Komisionit të jetë relator në një pozicion të lirë, ndërsa kryetari i Komisionit të jetë relator përzgjedhës për dy pozicione të tjera të lira.

Sa i përket relatorit për këto procedura të përzgjedhjeje të lëvizjes paralele, ai duhet të zgjidhen me short ndërmjet 3 anëtarëve të përhershëm të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme: në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Më pas, shorti do të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për 4 pozicionet përkatëse.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në dy pika, i cili i bashkëlidhet këtij relacioni. Unë nuk po e lexoj. Janë tre emrat e anëtarëve të Komisionit, për katër pozicionet për të cilat do të vijojë procedura e përzgjedhjes.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua edhe me mekanizmin e hedhjes së shortit?

Nuk ka diskutime.

Ftoj administratën të përgatisë hedhjen e shortit sipas mekanizmit të prezantuar nga relatori.

Procedura e hedhjes së shortit si vijon:

Vendosen në enën e parë të qelqit shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit: z. Klodian Kurushi, z. Markelian Koça, z. Albens Tabaku.

Vendosen në enën e dytë të qelqit shiritat e letrës me pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 260, datë 16.05.2024, vendimi nr. 489, datë 13.09.2024, vendimi nr. 492, datë 13.09.2024, vendimi nr. 493, datë 13.09.2024.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet gogla e parë, në të cilën relator rezulton z. Albens Tabaku.

Përzgjidhet gogla në të cilën ndodhet e shkruar pozicioni i lirë i shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024. Pra zoti Tabaku do të jetë relator për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024.

Përzgjidhet gogla e dytë, në të cilën relator rezulton z. Klodian Kurushi.

Përzgjidhen goglat në të cilën ndodhet e shkruar pozicioni i lirë i shpallur me vendimin nr. 493, datë 13.09.2024 dhe nr. 492, datë 13.09.2024. Pra zoti Kurushi do të jetë relator për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 493, datë 13.09.2024 dhe nr. 492, datë 13.09.2024.

Përzgjidhet gogla e tretë që ndodhet në enën e qelqit, në të cilën relator rezulton z. Markelian Koça.

Përzgjidhet gogla në të cilën ndodhet e shkruar pozicioni i lirë i shpallur me vendimin nr. 489, datë 13.09.2024. Pra zoti Koça do të jetë relator për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 489, datë 13.09.2024.

Ilir Rusi: Ju faleminderit!

Keni diskutime mbi mënyrën e hedhjes së shortit dhe rezultatet?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk keni diskutime atëherë, vazhdojmë në votimin e projektvendimit të përditësuar me të dhënat që rezultuan nga hedhja e shortit të tanishëm.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Tiranë për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 260, datë 16.05.2024; nr. 489, 492, 493 datë 13.09.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për këto procedura përzgjedhjeje për transferim nëpërmjet lëvizjeve paralele sipas numrit të pozicioneve të lira të shpallura, si më poshtë:

a) Për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 489, datë 13.09.2024 - relator z. Markelian Koça.

b) Për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024 - relator z. Albens Tabaku.

c) Për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 493, datë 13.09.2024 - relator z. Klodian Kurushi.

d) Për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 492, datë 13.09.2024 - relator z. Klodian Kurushi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 18 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.10.2024)

Pika 19 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Baisa Sefa, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLGJ-së.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Edmond Hoxha, BIRN (në sallë).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

19. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që është pika e fundit e kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Janë në total dy kërkesa të cilat janë të integruara në relacionin që unë do jua paraqes Këshillit. Kërkesat vijnë nga Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Deri më datë 15.10.2024, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, të Zëvendëskryetarit të

118

Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme:

Kemi një çështje penale. Objekti i akuzës janë nenet 78/2, 279, 333/a/2, 334 të Kodit Penal. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet është 3. Numri i kërkesës është 3626 dhe numri i çështjes është 107. Kërkohet caktimi i 3 (tre) gjyqtarëve për gjykimin e çështjes penale me të pandehur shtetasit {...}, {...}, {...} etj. (dosje penale e ndarë nga ajo e themelit në ngarkim të të pandehurve {...}, {...} etj – pasi vijohet me gjykim të shkurtuar.)

Kanë pengesë gjyqtarët {...} dhe {...} pasi kanë kryer veprime paraprake për procedimin penal në ngarkim të të pandehurve {...} etj.

Trupi gjykues i përbërë nga {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin nr. {...}, datë 11.04.2023, në ngarkim të të pandehurit në procedim të lidhur {...}.

Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: {...}, {...} dhe {...} kanë në gjykim aktualisht dosjen penale në ngarkim të të pandehurve {...} etj. (aktet e dosjes së sipërcituar ndodhen të administruara në dosjen hetimore që ka ardhur për gjykim në seancë paraprake me nr. {...} regjistrimi, datë 09.08.2023 në ngarkim të {...} etj.).

Trupi gjykues – janë shumë por unë do t'i përmend një nga një sepse kanë interes - i përbërë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin nr. 64, datë 10.11.2023 në ngarkim të të pandehurve {...} dhe {...}.

Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë aktualisht në gjykim dosjen penale nr. {...} akti, datë 08.03.2024 në ngarkim të të pandehurit {...}, si procedim i lidhur.

Kanë pengesë gjyqtarët {...}, pasi i është pranuar kërkesa për heqje dorë dhe gjyqtarja {...} – është pranuar kërkesa për përjashtim

Trupi gjykues i përbërë nga {...}, {...} dhe {...} kanë në gjykim shtetasit {...} dhe {...}.

Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë në gjykim të pandehurit {...}, {...} dhe {...} – për të cilët është pranuar kërkesa për gjykim të shkurtuar.

Kërkohet në këtë rast vijimi i procedurave për plotësimin e trupit gjykues me tre gjyqtarë nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm. Pikërisht në lidhje me këtë kërkesë të paraqitur nga Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të

Organizuar Komisioni bëri verifikimet përkatëse dhe ka rezultuar se, zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit bëhet i pamundur për t'u aplikuar në rastin konkret, për të përfshirë në skemën e delegimit gjyqtarë të cilët do duhet të gjykonin edhe çështjet që i referohen Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Njëkohësisht zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm bëhet i pamundur për t'u aplikuar në rastin konkret. Ndodhur në këto kushte, komisioni në këtë rast parashikon që të vihet në zbatim mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme.

Ky përcaktim mbështetet në paragrafin X/2 të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Përveç çështjes së parë, kemi edhe çështjen e dytë, që thashë, unë i përfshij në të njëjtin relacion.

Çështja e dytë i referohet situatës ku janë për gjykim veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/ 283/1, 333/a/2, 334/1 i Kodit Penal. Në çështjen e dytë kërkohen dy gjyqtarë për të plotësuar trupin gjykues. Kërkohet plotësimi i trupit gjykues me 2 (dy) gjyqtarë në çështjen penale me ngarkim të të pandehurit {...}. Trupi gjykues kryesohet nga gjyqtari {...}.

Kanë pengesë gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} – pasi kanë kryer veprime paraprake.

Gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin përfundimtar në ngarkim të të pandehurve {...}.

Gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin përfundimtar në ngarkim të të pandehurit {...}.

Gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin në ngarkim të të pandehurit në procedim të lidhur {...}.

Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë aktualisht në gjykim të pandehurit në procedim të lidhur shtetasin {...}.

Gjyqtare {...} ka në gjykim në seancë paraprake dosjen në ngarkim të të pandehurit {...}.

Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët {...}, {...}, dhe {...} ka në gjykim të pandehurit {...} (ku është pranuar kërkesa për gjykim të shkurtuar).

Edhe në këtë rast zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit bëhet i pamundur për t'u aplikuar pra edhe në këtë çështjen e dytë, pasi në skemën e delegimit janë aktualisht 5 gjyqtarë, konkretisht z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}, të cilët janë caktuar për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, dhe nuk ka gjyqtarë të tjerë të përfshirë në skemë delegimi për të gjykuar këtë çështje konkrete.

Njëkohësisht zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm bëhet i pamundur për t'u aplikuar në këtë rast. Kështu që edhe për rastin e dytë komisioni propozon të vihet në zbatim mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionet në mënyrë të përhershme.

Referuar kritereve të përcaktuara në paragrafin X/2 të vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, , njëkohësisht referuar në përcaktimet e shkronjës “c”, pika 5, Kreu IV, të këtij vendimi, në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të tij, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Gjykata nga ku duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 2 (dy) çështjeje gjyqësore të veçanta të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016.

Numri i gjyqtarëve që do duhet të caktohen me short për gjykimin e 2 (dy) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 5 (pesë). (3 për çështjen e parë dhe 2 për çështjen e dytë).

Në opsionin e pranimit të propozimit të mësipërm për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Për 2 (dy) çështje, për të cilat kërkohen nga 3 dhe 2 gjyqtarë, të përzgjidhen me short 5 të tillë, ndërmjet gjyqtarëve

të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart.

Përfshirjet nga shorti:

Referuar paragrafit VIII të vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit të mësipërm. Pra i përmenda më lart, prandaj kjo ishte arsyeja pse i përmenda një nga një gjyqtarët që kanë pengesë për të gjykuar të dyja këto çështje.

Gjithashtu edhe gjyqtarët të cilët më qenë ish-anëtarë të KLGJ-së, referuar pengesave ligjore dhe qëndrimit të mbajtur dhe janë gjyqtarët: znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Njëkohësisht, bashkëlidhur relacionit janë përfshirë edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për t’iu nënshtruar shortit dhe për të plotësuar trupat gjykuese të kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Unë po i lexoj një nga një.

Apo i keni?

T’jua kursej këtë pjesën?

Ok! Në rregull. Nëse i keni lexuar dhe i keni parë, nuk po i lexoj.

Mirë, faleminderit!

Këto janë propozimet tona.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, administrata të procedojë me hedhjen e shortit sipas relacionit dhe përfshirjes së atyre emrave që janë pjesë e relacionit.

Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 107, gjyqtarët e përzgjedhur janë Rexhep Bekteshi relator, dhe anëtarë Engjëllueshe Tahiri dhe Besmir Stroka.

Ilir Rusi: Faleminderit administratës.

Të vijohet me procedurën e dytë sepse ishin dy raste të prezantuara dhe referuara nga Gjykata e Posaçme.

Nga administrata referohet se: Sipas parashikimeve të relacionit, propozimeve të Komisionit, gjyqtarët e shortuar në çështjen e parë do të përjashtohen në çështjen e dytë. *(Kërkohet kohë nga administrata për azhurnimin e kërkesës në sistem për të vijuar më tej me shortin.)*

Ilir Rusi: Atëherë, i bëj thirrje administratës të marrë të gjitha masat organizative për hedhjen e shortit sipas relatimit të bërë nga relatori z. Kurushi, për të cilat nuk pati diskutime nga anëtarët prezent në këtë mbledhje.

Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën nr. 106, gjyqtarët e përzgjedhur Edvan Veçani dhe Alfred Konomi.

Ilir Rusi: Faleminderit administratës për hedhjen e shortit.

Me hedhjen e shortit dhe me shqyrtimin e kësaj pike, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mbasdite të qetë.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor